



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

URDHËR

Nr. 134, datë 27.04.2020

“PËR  
MIRATIMIN E FORMËS, MODALITETEVE DHE TË DHËNAVE QË PËRMBAN  
RAPORTI STATISTIKOR I VEPRIMTARISË SË PËRMBARUESIT GJYQËSORË  
PRIVATË”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 60, pika 5, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përbarimor privat”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e përmbajtjes dhe formatit të raportit statistikor vjetor të veprimtarisë së përbaruesit gjyqësor privatë, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.
2. Dispozitat e këtij urdhëri janë të detyrueshme për të gjithë përbaruesit gjyqësor privatë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë përbarimore në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Raporti statistikor vjetor i veprimtarisë së përbaruesit gjyqësor privat përmban të dhënat e mëposhtme:
  - a. Numrin e çështjeve përbarimore të regjistruara në regjistrin e çështjeve përbarimore;
  - b. Numrin e çështjeve të pushuara si të ekzekutuara terësisht, të pezulluara dhe aktive.
  - c. informacion në lidhje me administrimin e llogarisë bankare të veçantë.
4. Përbaruesi gjyqësor privat është i detyruar të mbajë dhe plotësojë raportin statistikor vjetor me të dhënat e nevojshme, të përcaktuara në aneksin 1 bashkëlidhur këtij urdhri. Nëse një ose disa përbarues gjyqësorë privatë organizohen në zyrë të përbarimit privat, çdo përbarues gjyqësor është i detyruar të mbajë dhe plotësojë raportin statistikor vjetor të veprimtarisë së tij.

5. Formati i raportit statistikor vjetor mbahet në formë elektronike. Formati elektronik konsiderohet programi Excel.
6. Përmbaruesi gjyqësor privat përgatit dhe dërgon në rrugë elektronike në adresën e administruar nga struktura përgjegjëse për veprimtarinë e shërbimit përmbarimor gjyqësor privat në Ministrinë e Drejtësisë dhe njëkohësisht Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, raportin statistikor vjetor të veprimtarisë së tij, sipas formës së përcaktuar në pikën 5 të këtij urdhri dhe i plotësuar në mënyrë të rregullt, çdo vit brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës.
7. Ngarkohen përmbaruesit gjyqësor privat, strukturat përgjegjëse për veprimtarinë e shërbimit përmbarimor gjyqësor privat në Ministrinë e Drejtësisë, dhe Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësor Privatë për zbatimin e këtij urdhri.
8. Ngarkohet Sektori i Arkiv Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**



**ETILDA GJONAJ (SALIU)**



## ANEKSI 1

### RAPORTI STATISTIKOR VJETOR PËR VEPRIMTARINË E PËRMBARUESIT GJYQËSOR PRIVAT

EMRI, MBIEMRI, VITI I RAPORTIT [       ]

LLOJI I TITULLIT EKZEKUTIV	Ceshtje ne Total	Ceshtje qe Kane Plotesuar Afatet Proceduriale			Ceshtje Brenda Afateve Proceduriale			Te Refuzuara	Te Pezulluara Vendim Gjyqate	Te Transferuara	Te Pushuara Neni 616/C	Vlera Ne Leke e Detyrimit	Llogaria bankare – Bilanci në mbaitien e llogarive të zvrës
		Ne Ekzekutim	Te Ekzekutuara	Te Pezulluara 615/D	Ne Ekzekutim	Te Ekzekutuara	Te Pezulluara 615/D						
TOTALI													